



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 116, datë 27.10.2022

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 32, DATË 26.03.2021 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, L.17, RRUGA "LURA", PALLATET NR.1&3, DHE RRUGA "AHMET DAKLI", PALLATET NR. 15 & 23, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019" I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit" i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model" i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit", i ndryshuar, si dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Aneksin 1 "Subjektet përfituese të 4 pallatave, Lagja 17", të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 32, datë 26.03.2021, "Për miratimin e listës së

përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për 4 banesa kolektive, L.17, Rruga "Lura", Pallatet nr.1&3, dhe Rruga "Ahmet Dakli", Pallatet nr.15&23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” i ndryshuar, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas tabelës, pjesë përbërëse e këtij vendimi, si më poshtë vijon:

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATËS	STRUKTURA E APARTAMENTIT, QË DO PËRFITOHET
72	DIANA XHEVAHIR ZAGANJARI	3	2+1
77	DRITAN XHELILAJ	5	3+1

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 28.10.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 834/prot.
17.

Durrës, më 08./11./2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës

KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.116 datë 27.10.2022 :

Për miratimin e ndryshimeve në aneksin nr 1, të VKB NR 32 dt 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për katër banesa kolektive, Lagja 17, Rruga “Lura”, Pallatet nr 1 dhe 3 dhe rruga “Ahmet Dakli” Pallatet nr 15 dhe 23, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019” i ndryshuar.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI

